



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
KRYETARI

Nr.1224/ 5Prot.

Tiranë, më 27.04.2017

V E N D I M

Nr. 33, Datë 27.04.2017

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
KUVENDIN E SHQIPËRISË “MBI ZBATIMIN E
RREGULLSHMËRISË FINANCIARE NË KUVENDIN E SHQIPËRISË”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm si edhe Drejtorit të Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”,

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit financiar “Mbi zbatimin e rregullshmërisë financiare në Kuvendin e Shqipërisë” për periudhën objekt auditimi 2014, 2015 dhe 2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESIT

Opinion i pakualifikuar (me theksim të çështjes)

Nga auditimi i pasqyrave financiare të Kuvendit të Shqipërisë, për vitin ushtrimor 2015 dhe 2016, u konstatua se këto pasqyra përfshijnë gjendjen ekonomike, pozicionin financiar hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyrat e amortizimit të krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, si dhe shënimet shpjeguese që janë të nevojshme për të shoqëruar këto pasqyra.

Në gjykimin tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë në të gjitha aspektet materiale lidhur me hyrjet dhe daljet në para, si dhe të buxhetit të realizuar nga Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2015 dhe 2016, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor.

Baza për Opinionin:

KLSH ka kryer auditimin në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Kuvendi i Shqipërisë dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

B. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

Gjetja 1

Nga auditimi në institucionin e Kuvendit, për zbatimin e procedurave të prokurimit për marrëveshjen kuadër me objekt “*Bileta për udhëtimet ndërkombëtare*”, u konstatuan mangësi në dispozitat nënligjore që rregullon zbatimin e marrëveshjes, për sa i takon masave që AK duhet të marrë në rastet kur konstaton se një operator ekonomik, palë në marrëveshje kuadër **nuk përmbush më** kriteret e kualifikimit, për të cilat është shpallur fitues. Konkretisht në udhëzimin nr 6, datë 27.01.2015 “*Për përdorimin e marrëveshjes kuadër*”, paragrafi 12, pika 12.6 parashikohet se në rast se AK konstaton mospërmbushje të detyrimit (sa i takon kriterëve të kualifikimit) duhet të veprojë konform nenit 47 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar. Ndërkohë që neni 47, i LPP parashikon se AK s’kualifikon çdo kandidat ose ofertues që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, **deri në shpalljen e kontratës fituese**. Pra konstatojmë se udhëzimi nr. 6, datë 27.01.2015 i referohet periudhës “**pas nënshkrimit të marrëveshjes kuadër**”, ndërsa neni 47 i LPP-së të cilin referon udhëzimi 6, datë 27.01.2015, parashikon periudhën **deri në fazën e lidhjes së kontratës**, duke lënë kështu “*të parregulluar*” ligjërisht se si duhet të veprojë AK, në rastet kur konstaton mospërmbushjen e kriterëve të kualifikimit, për të cilat operatori ekonomik është shpallur fitues në marrëveshje.

Rekomandimi

Duke qenë se neni 47, i LPP, përcakton rastet e skualifikimit të ofertuesve që paraqesin në një procedurë prokurimi për kualifikim, të dhëna të rreme, (para lidhjes së kontratës) ndërsa në

udhëzimin e APP nr. 6, datë 27.01.2015 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër”, parashikohet mos përmbushja e detyrimeve për sa u takon kriteret e kualifikimit (pas lidhjes së kontratës), Agjencia e Prokurimit Publik duhet **të rishikojë** paragrafin 12, pika 12.6 të udhëzimit nr 6, datë 27.01.2015, duke reflektuar saktë dhe në mënyrë specifike rastet kur gjatë minikonkursit, konstatohet se, pas verifikimit të kriterit të kualifikimit (në rastin konkret, marzhi i fitimit), OE nuk përmbush më kriteret e kualifikimit, për të cilat është shpallur fitues në këtë marrëveshje.

Rekomandojmë gjithashtu, që në udhëzimin respektiv të parashikohet qartë edhe mënyra se si ky marzh fitimi do të verifikohet në kuadër të përmbushjes së kriterit të kualifikimit, për të cilën **sugjerojmë** që, për çdo faturë biletë, OE fitues të sjellë edhe BSP (Billing and settlement plan) (e cila në vetvete tregon koston e biletës për operatorin), që do t’i shërbejë Autoritetit Kontraktorë (KVO-së) për përlllogaritjen e marzhit të fitimit, dhe verifikimin nëse marzhi i përlllogaritur përputhet me vlerën e marzhit të deklaruar në marrëveshjen kuadër.

Menjëherë

Gjetja 2

Nga auditimi u konstatua se, për pagesën e të ardhurave për pjesëmarrje në komisionet parlamentare të deputetëve është mbajtur tatim në burim, në masën 15% e shumës së përfituar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si edhe me kërkesat e udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar, pika 2.3.1. Administrata e Kuvendit ka zbatuar pikën 5, germa “c” të vendimit të Kuvendit nr. 114/2014, datë 24.12.2014, “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”, ku parashikohet se: “*Tatimi i shpërblimeve për pjesëmarrje në komisione do të konsiderohet si tatim në burim*”. Ky përcaktim bie në kundërshtim me sa parashikohet në nenin 9, pika 1/a e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998.

Rekomandimi

Institucioni i Kuvendit të Shqipërisë t’i kërkojë Byrosë së Kuvendit shfuqizimin e pikës 5, germa “c” e vendimit nr. 114/2014, datë 24.12.2014, “Për mënyrën e trajtimit të deputetëve”.

Menjëherë

MASA ORGANIZATIVE

Gjetja 1

Ngritja e sektorit të Auditit të Brendshëm nuk bazohet në kriteret e përcaktuara në nenin 17, të ligjit nr, 9720, datë 23.4.2007 ‘Për auditimin e brendshëm në sektorin publik’, i ndryshuar, në pikën 1, të VKM nr. 212, datë 30.3.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” dhe as në kërkesat e vkm nr. 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore,...”. Ndryshimet ligjore për auditimin e brendshëm publik, kanë krijuar mundësinë që njësia e auditimit të brendshëm të organizohet dhe të funksionojë edhe në Kuvendin e Shqipërisë, e për rrjedhojë organizimi i këtij sektori duhet bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 10 e 26, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 dhe në pikat 1 e 3, të vkm nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Rekomandimi

Institucioni i Kuvendit të marrë masat e duhura për organizimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë dhe funksionimin e këtij shërbimi, duke përfshirë sektorin në një drejtori, ose duke e kontraktuar shërbimin e auditimit të brendshëm me njërin nga opsionet e

parashikuara në nenin 10, të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”.

Menjëherë

Gjetja 2

Nga auditimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm u konstatua se:

- në përgatitjen e planit strategjik dhe vjetor, për të tre vitet objekt auditimi, nuk i është përmbajtur formatit që kërkon Manuali i Auditimit të Brendshëm, i cili ndër të tjera kërkon të reflektohet *misioni, vizioni, objektivat strategjike mbi bazë të analizës së risku, si dhe strategjia e auditimit për një periudhë 3-5 vjeçare; dhe*
- janë konstatuar mangësi në dokumentacion në dosjet e auditimit të brendshëm që lidhen me programin e masave, dokumentimin e rishikimit të brendshëm të cilësisë, etj në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 12, datë 05.06.2012 “*Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik*”. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, të gjitha dosjet e auditimit të brendshëm, rezultojnë të painventarizura, sipas kërkesave të parashikuara në “*Normat-tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*”, në zbatim të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “*Për Arkivat*”. Gjithashtu konstatohet se për këto dosje, shkresat dhe/ose dokumentet që lidhen me të nuk janë evidentuar me të njëjtin numër progresivisht me fraksion, deri në mbyllje të praktikës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003.

Rekomandimi

- Sektori i Auditit të Brendshëm të marrë masat e duhura për përgatitjen e Planit Strategjik dhe vjetor, larg parashikimeve formale, si dhe programimin e veprimtarisë audituese në mënyrë sa më efektive, për të parashikuar mbulimin e risqeve kryesore gjatë një periudhe 3-5 vjeçare.
- Sektori Auditit të Brendshëm, në bashkëpunim me Sektorin e Arkivës, të marrin masa për plotësimin dhe administrimin e dosjeve të auditit të brendshëm, duke caktuar për çdo dosje një numër rendor, në mënyrë të tillë që të gjithë dokumentat, që lidhen me të, të evidentohen me të njëjtin numër progresivisht me fraksion deri në mbyllje të praktikës.

Në vijimësi

Gjetja 3

Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit konstatohet se programimi është prekur nga Aktet Normative si në vitin 2015 dhe në vitin 2016, ndërkohë realizimi faktik me planin janë larg.

Rekomandimi

Strukturat drejtuese të Kuvendit të Shqipërisë, dhe strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos, me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve të larta mes nivelit të programuar dhe atij të realizuar.

Në vijimësi

Gjetja 4

Nga auditimi u konstatua se për përlllogaritjen e amortizimit përgjithësisht janë përdorur saktë normat e amortizimit në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, përveç rastit të konstatuar të inventarit ekonomik (Ilogaria 218), nga ku rezulton se, është përfshirë në këtë llogari zëri “piktura” me kosto historike 4,505,023 lekë, duke u amortizuar me normën 3%, ndërkohë që bazuar në standartet ndërkombëtare të kontabilitetit publik – SNKP 17, këto aktive nuk amortizohen pasi vlera e tyre, ndryshe nga

gjithë aktivet e tjera, jo vetëm nuk pakësohet (për efekt amortizimi), por shtohet me kalimin e kohës.

-Sipas të dhënave që disponon Drejtoria e Shërbimit të Transportit dhe të konfirmuara në inventarët fizik të aktiveve qarkulluese, në magazinën e parkut të autoveturave më datë 31.12.2016 ndodhen gjendje 754 artikuj, pjesë këmbimi në vlerën 9,477,167 lekë mbi nevojat dhe që nuk përdoren për shkak të pakësimit të numrit të mjeteve në dispozicion të Kuvendit, në zbatim të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, si dhe për faktin se disa tipe mjeteve si *FIAT UNO, FIAT TIPO, PEUGOT, BENZ 240, BMW*, etj, janë hequr nga shfrytëzimi në vitin 2003. Për evadimin e këtyre mallrave (pjesë këmbimi për autovetura) të konsideruara stok e me qarkullim të ngadalshëm u konstatua se ky sektor ka filluar punë për përgatitjen e dokumentacionit për shitjen e tyre me ankand.

Rekomandimi

Njësia e Financës të bëjë sistemimin kontabël për shpenzimet e amortizimit, të cilat për zërin “pikturë” nuk janë përlllogaritur drejt, me qëllim reflektimin të këtij zëri në pasqyrat financiare të institucionit.

Me qëllim që të rriten të ardhurat e institucionit dhe të rikuperohen fondet e ngurtësuara të aktiveve qarkulluese, Drejtoria e Shërbimit të Transportit, të ndjekë me përparësi shitjen e pjesëve të këmbimit të autoveturave me ankand.

Menjëherë

Gjetja 5

Nga auditimi me përzgjedhje i urdhër shpenzimeve janë konstatuar 5 raste udhëtimesh që lidhen me shërbimet jashtë vendit, për pjesëmarrje në konferenca dhe takime ndërkombëtare, për të cilat, edhe pse nën nivelin e materialitetit për nga vlera, nevojitet dokumentim i kujdesshëm i praktikave shoqëruese, të merret miratimi i Kryetarit të Grupit Parlamentar për mos kryerjen e udhëtimit para afatit të përcaktuar, me qëllim verifikimin dhe argumentimin e deviancave nga datat ose itineraret e parashikuara.

Rekomandimi

Nga Drejtoria e Financës të kërkohet plotësimi me rigorozitet i dokumentacionit dhe praktikave shoqëruese të udhëtimeve të deputetëve, me qëllim minimizimin e shmangieve nga itineraret e përcaktuara dhe reduktimin e impakteve financiare të këtyre shmangieve.

Në vijimësi

Gjetja 6

Nga auditimi i strukturave organike për periudhën objekt auditimi u konstatua se, për vitin 2014, rreth 12% e pozicioneve paraqiten vakante, për vitin 2015 rreth 5%, dhe për vitin 2016 rreth 10% e tyre, si për shembull paraqiten vakante pozicionet e Këshilltarëve Juridikë, në Shërbimin Legjislativ, detyrat e të cilëve lidhen me funksionet parësore të Kuvendit të Shqipërisë siç janë hartimi apo amendimi i ligjeve, apo dhe pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Legjislativ i cili paraqitet vakant prej tre vitesh. Krijimi i vendeve vakante dhe listave të pritjes, janë kosto të shtuara për institucionin.

Rekomandimi

Institucioni të marrë masa për të plotësuar vendet vakante ose për të rishikuar strukturën organike, me qëllim që detyrat e parashikuara për këto funksione të minimizojnë risqet që mund të cenojnë realizimin e funksioneve të Kuvendit të Shqipërisë.

Në vijimësi

Gjetja 7

Nga auditimi i procedurës së prokurimit për “Shërbimin e mirëmbajtjes e-Parlament, Software dhe Hardware” u konstatua se nuk janë respektuar kërkesat e VKM nr. 710, datë 21.08.2013 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”*, në pikën, 2 germa b, të të cilit parashikohet detyrimi për të lidhur marrëveshjen për mirëmbajtjen e sistemeve, për ato institucione që kanë sisteme ekzistuese, për një periudhë jo më e shkurtër se 2 vjet. Nga auditimi u konstatua se, ky shërbim është prokuruar për 4 muaj por është ofruar për 2 muaj.

Rekomandimi

Marrjen e masave që në vijim institucioni të kryejë analizën e nevojave për marrëveshjet nivel shërbimi për sistemet ekzistuese dhe ato të reja, për të cilat të planifikojë me kujdes fondet dhe angazhimet e nevojshme buxhetore, për realizimin me sukses të këtyre marrëveshjeve.

Në vijimësi

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

KRYETAR